



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
MINISTRI

Nr. 6148 Prot.

Tiranë, më 24.08. 2015

UDHËZIM

Nr. 30, datë 24.08.2015

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 24, DATË 31.07.2015 "PËR ZHVILLIMIN E KONKURSEVE TË PRANIMIT DHE TARIFËN E REGJISTRIMIT PËR KONKURRIM NË DISA PROGRAME STUDIMI TË CIKLIT TË PARË MË KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2015 -2016"**

Mbështetur në Nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Nenet 33 dhe 75 të ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimin nr. 638, datë 22.08.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015 - 2016", si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 08.02.2006 "Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Në Udhëzimin nr. 24, datë 31.07.2015, në fund të pikës 7, shtohet fjalia si më poshtë:  
*"Për Universitetin e Arteve të Tiranës periudha e regjistrimit të jetë deri në orën 12.00 të datës 25 Gusht 2015."*
2. Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) dhe Universiteti i Arteve të Tiranës.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në "Fletoren Zyrtare".

**LINDITA NIKOLLA**

**MINISTËR**

